



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRI E ARSHMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Nr. / No. <b>250</b>	Nr. i faq. / Dr. str / No. pg <b>1</b>	
Data / Datum / Data: <b>07.02.2023</b>		Pejë / Poë

**Këshilli Drejtues**

**Datë: 06.02.2023**

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 03.02.2023, morri këtë:

### VENDIM

- I. MIRATOHET Rregullorja për Qendrën e Ekselencës, në "Universitetin Haxhi Zeka", në Pejë.
- II. Këtij vendimi i bashkangjitet Rregullorja për Qendrën e Ekselencës, në UHZ, në Pejë.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së  
Prof. Ass: Dr. Majlinda Belegu



**Vendimi t'i dërgohet:** Kryesueses së KD-së, Anëtarëve të KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës së UHZ-së.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

---

Adresa: Rruga e UÇK-së 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Tel: + 383 039 432 270, info@unhz.eu

---

**RREGULLORE PËR QENDRËN E EKSELENCËS NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" PEJË**

## **Themelimi Neni 1**

Qendra e Ekselencës është themeluar në bazë vendimit të Këshillit Drejtues të UHZ-së me nr. prot: 412 dt: 03.03.2022.

## **Qëllimi Neni 2**

Qendra e Ekselencës (në tekstin e mëtejshëm QE) ka për qëllim të ndihmojë Universitetin e "Haxhi Zeka" në Pejë duke ofruar trajnime stafit akademik të rregullt për avancimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin e sistemeve mësimore të cilat promovojnë mësimdhënien më efektive dhe më cilësore, në funksion të transformimit të UHZ-së në një universitet konkurrent me universitetet më të mira në Rajon dhe në Botë.

## **Misioni Neni 3**

1. Misioni i QE-së është rritja e efektivitetit dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në UHZ nëpërmjet:
  - 1.1. Organizimit dhe realizimit të aktiviteteve që kontribuojnë dhe sigurojnë avancimin e aftësive dhe kompetencave të stafit akademik;
  - 1.2. Promovimit të kulturës së përsosmërisë akademike nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe praktikave më të mira në mësimdhënie;
  - 1.3. Ofrimit të shërbimeve në fushën e përsosmërisë në mësimdhënie (zhvillimin e kurrikulave, përgatitjen e materialeve mësimore, angazhimin dhe vlerësimin permanent të studentëve, aplikimin e metodave hibride në mësimdhënie, mësimin e bazuar në platformat elektronike etj.
  - 1.4. Mbështetjes së Fakulteteve dhe stafit akademik në lidhje me zbatimin e praktikave inovative dhe të dëshmuara në mësimdhënie, mentorim dhe vlerësim të studentëve;
  - 1.5. Promovimit dhe ofrimit të shërbimeve në lidhje me zbatimin e standardeve të etikës në mësimdhënie.
2. Trajnerët përdorin "CourseSites" dhe platforma tjera online të organizimit dhe menagjimit të kurseve për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e mësimdhënies së tyre;

## **Aktivitetet Neni 4**

1. Hulumtimin dhe identifikimin e nevojave për trajnime në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
2. Organizimin e trajnimeve për metodat bashkëkohore të mësimdhënies për stafin akademik të rregullt;
3. Identifikimi dhe prioritizimi i sfidave, nevojave dhe mundësive që UHZ-ja t'i adresojë nëpërmjet trajnimeve dhe programeve të ofruara në QE.

4. Zhvillimi dhe realizimi i trajnimeve që do të plotësojnë nevojat e stafit akademik në UHZ dhe institucioneve tjera të Arsimit të Lartë.
5. Identifikimi dhe zhvillimi i formave alternative të mbështetjes financiare për QE dhe inkurajimi i donatorëve për të investuar në përmirësimin e mësimdhënies në UHZ.
6. Zhvillimi i procedurave për monitorimin dhe raportimin e rezultateve.

### **Struktura Neni 5**

3. QE-ja përbëhet nga:
  7. Këshilli i trajnerëve
  8. Drejtori i QE – së
  9. Zyra për Mësimdhënie dhe Çështje Akademike

### **Këshilli i Trajnerëve Neni 6**

1. Këshilli i trajnerëve themelohet nga Senati sipas propozimit të rektorit të UHZ – së, për një mandat 4 vjeçar;
2. Këshilli i trajnerëve (në tekstin e mëtejme Këshilli) është organi drejtues i QE-së. Këshilli fillimisht përbëhet nga trajnerë të lartë të certifikuar dhe në marrëdhënie të rregullt të punës në UHZ, si dhe deri në 2 trajner të certifikuar kombëtar apo ndërkombëtar që nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ.
3. Anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote dhe pa të drejtë të llogaritjes në kuorum janë edhe trajnerët e certifikuar të pensionuar, të cilët vazhdojnë të jenë aktiv në procesin mësimor në UHZ.
4. Anëtarët e Këshillit duhet të demonstrojnë angazhimin e tyre për mësimdhënie moderne, kreative, të përmirësuar dhe efektive dhe duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë përdorimin dhe / ose zotërimin e platformës online të menaxhimit të kurseve. Ata duhet të ofrojnë rolin shembullor tek anëtarët e tjerë të stafit të Universitetit të Pejës duke zhvendosur kurset e tyre në një platformë të tillë sa më shpejt që të jetë e mundur.
5. QE-ja i nënshtrohet "rifreskimit" të anëtarësisë çdo vit me katër (4) anëtar të ri të përkushtuar ndaj idesë së transformimit dhe avancimit të mësimdhënies në sistemin e Arsimit të Lartë. Numri i trajnerëve që përbëjnë Këshillin është i kufizuar në 11 prej të cilëve 7 trajner të lartë dhe 4 trajner të ri, përveç nëse mungesa e trajnerëve të certifikuar pamundëson ruajtjen e kësaj përbërje.
6. Anëtarësia në Këshill përfundon në këto raste:
  - 6.1. Kur një anëtar jep dorëheqje;
  - 6.2. Kur një anëtar ka vepruar në kundërshtim me parimet e punës;
  - 6.3. Kur një anëtar nuk përmbush përgjegjësitë e anëtarësisë:
    - 4.3.1. Pjesëmarrjen në së paku 75% të takimeve të përgjithshme
    - 6.3.2. Pjesëmarrjen në aktivitete të tjera organizative;
    - 6.3.3. Përfaqësimin e misionit, qëllimit dhe zhvillimin e aktivitetit të tyre në UHZ në përputhje me zhvillimin strategjik të QE-së.
  - 6.4. Për arsye shëndetësore;
  - 6.5. Në rast të dënimit për vepër penale; dhe
  - 6.6. Ndërprerjes së angazhimit në UHZ.



**Trajnerët e Rinj**  
**Neni 7**

Trajnerët e rinj janë anëtarë të stafit të rregullt të UHZ-së të cilët janë certifikuar në bazë të përfundimit të suksesshëm të programit Trajnimi për Trajnerë.

**Drejtori**  
**Neni 8**

1. Drejtori i QE-së duhet të jetë anëtar i QE-së dhe emërohet nga Rektorit për një periudhë 4 vjeçare;
2. Përgjegjësitë dhe detyrat specifike të drejtorit përcaktohen në vendimin e emërimit.
3. Drejtori i QE-së i raporton rektorit ose prorektorit për mësimdhënie dhe çështje të studentëve.
4. Për punën e Qendrës, Drejtori raporton te Këshilli i QE-së dhe Këshilli Drejtues i UHZ - së.

**Kualifikimet për Drejtor të QE – së**  
**Neni 9**

1. Kandidati i cili emërohet në pozitën e drejtorit të QE – së, duhet ti plotësoj këto kushte:
  - 1.1. Të jetë mësimdhënës i rregullt në UHZ, më thirrjen se paku prof. ass;
  - 1.2. Të ketë përvojë në mësimdhënie mbi 10 vite;
  - 1.3. Të njoh gjuhë të haja;
  - 1.4. Të jetë i certifikuar ndërkombëtarësh për metodat bashkëkohore të mësimdhënies;
  - 1.5. Të ketë përfomancë të mirë në mësimdhënie;

**Përfundimi para kohe i mandati të Drejtorit**  
**Neni 10**

1. Mandati i drejtorit mund të përfundojë para kohe në rast të:
  - 1.1. dorëheqjes;
  - 1.2. shkarkimit nga detyra;
  - 1.3. arsye shëndetësore;
  - 1.4. dënimit për vepër penale;
  - 1.5. pensionimit;
  - 1.6. vdekjes.
2. Shkarkimi nga detyra i drejtorit mund të bëhet në rastet kur vepron në kundërshtim më Statutin e UHZ – së, Kodin e Etikës dhe aktet tjera të UHZ – së.
3. Vendimin për shkarkim e merr Rektorit pas të jetë konsultuar më Këshillin e Qendrës së Ekselencës:

**Zyra për Mësimdhënie dhe Çështje Akademike**  
**Neni 11**

1. Drejtori i zyrës për mësimdhënie dhe çështje akademike është person kompetent dhe i motivuar për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me kontratë.
2. Drejtori i zyrës për mësimdhënie dhe çështje akademike është anëtar i këshillit të QE -së, sipas detyrës zyrtare pa të drejtë vote, i cili është përgjegjës për punët administrative të lidhura me funksionimin eflkas të QE-së.

**Takimet**  
**Neni 12**

1. Anëtarët e këshillit të trajnerëve të QE-së organizojnë së paku 4 takime në vit.
2. Mbledhjet organizohen më shumë se katër herë në vit nëse këtë e kërkon Drejtori i QE-së ose së paku një e treta e anëtarëve të këshillit.
3. Kuorumi konsiderohet valid nëse në takim janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve të këshillit të trajnerëve të QE-së.
4. Anëtarët konsiderohen si të pranishëm në qoftë se ata komunikojnë nëpërmjet Skype ose platformave tjera të video-konferencës.

**Plani i trajnimeve dhe plani buxhetor**  
**Neni 13**

1. Plani i trajnimeve për vitin vijues hartohet nga këshilli i QE – së në bazë të nevojave të njësive akademike dhe specifikave të tyre dhe është obligativ për të gjithë stafin akademik;
2. QE çdo viti në muajin dhjetor harton planin e trajnimeve për vitin vijues, i cili miratohet nga Këshilli i QE – së, më shumicë absolute të votave;
3. Plani buxhetor i QE – së, hartohet në muajin janar nga këshilli, i cili dërgohet për aprovim final në Këshillin Drejtues të UHZ – së.

**Kryesuesi i Këshillit**  
**Neni 14**

1. Këshilli kryesohet nga drejtori i QE-së.
2. Drejtori mund të emëron një nga anëtarët e Këshillit për të kryesuar përkohësisht takimet.
3. Vendimet e marra në takimin e Këshillit të QE-së nënshkruhen nga Drejtori i QE-së.

**Vendimmarrja**  
**Neni 15**

1. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Çdo anëtar ka një votë.
3. Në rast se numri i votave në favor dhe kundër një propozimi është i barabartë, atëherë vota e kryesuesit është vendimtare.

4. Anëtarët e Këshillit tërhiqen nga votimi për çdo çështje në të cilën ata kanë konflikt interesi.

**Hyrja në fuqi  
Neni 16**

1. Kjo Rregullore miratohet me dy të tretat e votave të anëtarëve të Këshillit dhe i dërgohet për aprovim Këshillit Drejtues të UHZ-së
2. Rregullorja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Këshillit Drejtues të UHZ-së.

**Ndryshimet  
Neni 17**

Ndryshimi apo plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

**Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së**

**Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu**



*Majlinda Belegu*